

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"METROTECH" SH.P.K

Sot në Tiranë, me datë 01.03.2022, themeluesit e shoqërisë tregtare si më poshtë vijon:

- **Z. Arben ÇELA**, atësia Skënder, i datëlindjes 12/08/1958, lindur ne Tirane dhe banues në adresën Fshati Tagan, Petrelë, Tiranë, Shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit personal me Nr. F90812031M, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- **Z. Elton DOMNORI**, atësia Kujtim, i datëlindjes 02/06/1982, lindur në Shkodër dhe banues në adresën Rr. "Stavri Themeli", Nd. 45, Ap. 26, Njësia Administrative nr. 7, Tiranë, Shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit personal me Nr. I20602102O, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- **Z. Arjan ÇUKAJ**, atësia Qerim, i datelindjes 11/06/1969, lindur ne Sarande dhe banues në adresën Rr. Zef Jubani, Nd.10 H.1 Ap.37, Njesia Administrative Nr.5, Tirane, Shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit personal me Nr. G90611106E, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Të cilët së bashku me vullnetin e lirë, vendosën të nënshkruajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar (*me poshtë Shoqëria*), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni Shqiptar në fuqi si Kushtetuta, Kodin Civil, ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*", ligji Nr. 131, datë 26.11.2015 "*Për Qendrën Kombëtare të Biznesit*", dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti, me kushtet si më poshtë vijon:

Neni 1

Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë së vendosur nga themeluesit është "**METROTECH**" SH.P.K.

Neni 2

Selia

Selia e Shoqërisë është e vendosur në Tiranë, në adresën Rruga Budi, Nr. 74, Bashkia Tiranë, Shqipëri.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

AC


Neni 4

Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në:

- a) Në fushën e IT-së përmes programimit, zhvillimit të softwarit, helpdesk, front-end dhe back-end, hardware, networking, etj;
- b) Projektim, instalim i sistemeve, rrjeteve dhe pajisjeve fundore të telekomunikacionit, programimi dhe instalimi i sistemeve të telekomunikacionit etj, në fushën e shërbimeve Software dhe platformave Software-ike;
- c) Dizenjim software-i, e cila përfshinë analizën e kërkesave të sistemit software, projektimi i arkitekturës dhe projektimi i detajuar i sistemit software;
- d) Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh Software dhe platformave Software-ike, e cila përfshinë programim të sistemeve software, kodimi, instalimi, integrimi i të gjithë komponentëve, dokumentimi, identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve, modifikimet (pas momentit që software-i është vendosur në operim), mirëmbajtja e të gjithë komponentëve, suporti i sistemit si një tërësi komponentësh, që në funksionimin e tyre, realizojnë qëllimin e zgjidhjes informatike;
- e) Testim software, e cila përfshinë testimin e funksionaliteteve, të ngarkesës në punë, të performancës, të pranimit, të disponueshmërisë dhe të sigurisë së sistemit software;
- f) Dizenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit, si analiza, planifikimi, projektimi, zbatimi, vendosja në punë dhe mirëmbajtja e sistemeve të komunikimit të rrjeteve të pajisjeve informatike (LAN/ WAN/ WLAN/ MAN/ SAN/ CAN);
- g) Dizenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë, si analiza e kërkesave të sigurisë së klientit, projektimi i arkitekturës, instalimet dhe konfigurimet e komponentëve, vendosja në punë, testimet e sigurisë dhe mirëmbajtja përkatëse;
- h) Zhvillim sistemesh migrimi, e cila përfshinë transferimin e të dhënave dhe infrastrukturës përkatëse nga një teknologji të vjetër në një teknologji të re;
- i) Përmirësim/upgrade sistemesh dhe programesh kompjuterike;
- j) Operimi i qendrave të të dhënave, suporti i përdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik për sistemet software, administrimi i tyre, krijim i qendrave apo bazave të informacionit për grumbullimin, përpunimin apo shpërndarjen e sistemeve të informacionit;
- k) Konsulencë të menaxhimit dhe arkitekturës teknologjike, si dhe për ndërtim të departamenteve inxhinierike dhe infrastrukturës;

A.C



- l) Konsulencë të strategjisë së IT-së për biznese në ndihmë të prokurimeve, burimeve njerëzore dhe planit të biznesit;
- m) Prodhim, shpërndarje dhe tregtim me shumicë dhe pakicë, eksport-import i pajisjeve dhe sistemeve informatike e kompjuterike hardware dhe software, ngritja e dyqaneve me artikuj dhe shërbime të teknologjisë dhe informacionit, mbajtja, riparimi dhe marrja me qira e pajisjeve dhe mjeteve elektronike për përpunimin e të dhënave, si dhe shërbime të tjera të lidhura me to;
- n) Menaxhimi i qendrave të përpunimit të të dhënave dhe të rrjeteve informatike të çdo lloji, përgatitja dhe mirëmbajtja e faqeve të internetit, ofrim domen-esh, shërbime web-hosting, përgatitja dhe mirëmbajtja e rrjeteve sociale në internet si dhe marketing online;
- o) Menaxhimi i kurseve për informatikë dhe organizim të ndërmarrjes. Për këtë aktivitet në përputhje me legjislacionin në fuqi, mbetet e kuptuar se detyra të tilla profesionale do t'i ngarkohen drejtëpërdrejt profesionistëve, rregullisht të aktivizuar në varësi të rastit, nën përgjegjësinë e tyre;
- p) çdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të shoqërisë në fushën e IT-së që nuk është përmendur në këtë akt dhe që nuk bie ndesh me legjislacionin Shqiptar në fuqi.
- q) Dhe çdo veprimtari tjetër që nuk ndalohet nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

Neni 5

Kapitali Themeltar




Kapitali Themeltar i Shoqërisë është **100 (njëqind) Lekë**. Kapitali Themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 3 (tre) kuota, të gjitha të nënshkruara, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakëve në kapitalin Themeltar të Shoqërisë përcaktuar në neni 10 (dhjetë) të Statutit.

Neni 6

Kontributet

Kuotat e Shoqërisë që zotërohen nga ortakët e shoqërisë:

- **Z. Arben ÇELA** zotëron 20 % të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga 1 (një) kuotë, me vlerë prej 20 (Njëzet) Lek;
- **Z. Elton DOMNORI** zotëron 20 % të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga 1 (një) kuotë, me vlerë prej 20 (Njëzet) Lek;
- **Z. Arjan ÇUKAJ** zotëron 60 % të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga 1 (një) kuotë, me vlerë prej 60 (Gjashtëdhjetë) Lek.

Neni 7

Transferimi i Kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të nenit 11 të Statutit.

Neni 8

Administrimi

1. Me këtë Akt Themelimi emërohet **1 (një)** Administrator i Shoqërisë personi si më poshtë vijon:
 - **Z. Elton Domnori**, i biri i Kujtimit, i datëlindjes 2/06/1982, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë, Shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit personal me Nr. I206021020, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
2. Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*" i ndryshuar, dhe nenit 14 të Statutit.
3. Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim Administratori mund t'i drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund t'i delegojë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit sa më lartë cituar.

Neni 9


Gjuha

Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) ekzemplarë në gjuhën shqipe, duke patur secili ekzemplarin orgjinal dhe nënshkruhet rregullisht nga themeluesit.

THEMELUESIT E SHOQËRISË


"METROTECH" SH.P.K

Z. Arben ÇELA




(Emër, Mbiemër, Firmë)

Elton DOMNORI



(Emër, Mbiemër, Firmë)

Arjan ÇUKAJ



(Emër, Mbiemër, Firmë)

